



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /  
GOVERNMENT OF KOSOVA



Ministria e Punëve të Brendshme  
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova  
Ministry of Internal Affairs

DEPARTAMENTI I INSPEKTIMIT

Inspektorati Policor i Kosovës  
Policijski Inspektorat Kosova  
Police Inspectorate of Kosovo

---

## Raport inspektimi Nr. 5/2012

# VLERËSIMI I PROCEDURAVE TË HETIMIT TË RASTEVE TË AKSIDENTEVE TË TRAFIKUT NË POLICINË E KOSOVËS



Korrik 2012

## **SHKURTESAT**

<b>MPB</b>	<b>Ministria e Punëve të Brendshme</b>
<b>IPK</b>	<b>Inspektorati Policor i Kosovës</b>
<b>PK</b>	<b>Policia e Kosovës</b>
<b>SHPK</b>	<b>Shërbimi Policor i Kosovës</b>
<b>DPPK</b>	<b>Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës</b>
<b>NJTR</b>	<b>Njësia e Trafikut Rajonal</b>

# PËRMBAJTJA

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	4
2. HYRJE.....	6
3. PËRMBLEDHJA E TË GJETURAVE NË PËRGJITHËSI.....	8
3.1 Identifikimi dhe vlerësimi përputhshmërisë së procedurave të aksidenteve të trafikut.....	8
3.2 Identifikimi dhe vlerësimi i përmbajtjes së formave zyrtare për Aksidentet trafikut.....	9
3.3 Identifikimi dhe vlerësimi i zbatimit të procedurave për aksidentet në trafik në fuqi.....	10
4. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET.....	18
4.1 Përfundimi.....	18
4.2 Rekomandimet.....	20

## 1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.1 Bazuar në autorizimet dhe funksionet që dalin nga Ligji për Inspektoratin Policor të Kosovës, Departamenti i Inspektimeve ka ndërmarrë një inspektim në Policinë e Kosovës gjegjësisht Njësitë e Trafikut Rajonal, në fushën e hetimit të rasteve të aksidenteve në trafikun rrugor. Për shkak të natyrës dhe ndjeshmërisë që ka zbatimi i procedurave të hetimit të aksidenteve të trafikut, të cilat kanë të bëjnë me gjetjen e shkaktarëve të aksidenteve të trafikut përmes zbatimit të procedurave dhe formave zyrtare, Inspektorati Policor i Kosovës është fokusuar që të bëjë inspektimin e kësaj fushe me qëllim që të identifikoj dhe vlerësoj çështjet e zbatimit të procedurave të hetimit të aksidenteve të trafikut dhe në respektimin e këtyre rregullave në praktikë.

1.2 Në bazë të dispozitave ligjore në fuqi si dhe parimeve e procedurave të PK-së, përgjegjësia për hetimin e rasteve të aksidenteve të komunikacionit i takojnë Njësitë të Trafikut Rajonal të PK-së që janë të ndara në gjashtë regjione kryesore.

1.3 Gjatë kontrollimit të dosjeve hetimore të aksidenteve në trafik në (6) gjashtë Njësi Rajonale të Trafikut Rrugor, me një total prej 99 dosjeve të kontrolluara janë përdorur kriteret matëse të garantuara nga: Kodi Penal, Ligji i Policisë, Ligji për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor, Ligji Për Përdorimin e Simboleve Shtetërore të Kosovës, Doracakun Operacional për Trafik, Doracakun i Parimeve dhe i Procedurave si dhe Udhëzimi Administrativ për Mënyrën e Kryerjes së Detyrave dhe Ushtrimit të Autorizimeve Policore.

1.4 Me identifikimin dhe vlerësimin e përputhshmërisë së procedurave të Hetimit të Aksidenteve të Trafikut, është gjetur se Njësitë e Trafikut Rajonal edhe pse tanimë kanë një rregullativë ligjore, Ligjin Për Komunikacion, akoma nuk kanë Procedura Standarde të Operimit në pajtim me këtë ligj dhe ndryshimet infrastrukturore në Kosovë. Njësitë e Trafikut Rajonal ende punojnë me Doracakun Operacional për Trafik i cili duhet të rishikohet dhe të plotësohet me ndryshimet e reja në Republikën e Kosovës. Procedura Standarde e Operimit (PSO) do të duhej të përshkruante dhe përcaktonte në mënyrë unike standardet e punës së NJTR duke përfshirë: autorizimet, fushëveprimet, detyrat dhe kufizimet e autorizimeve, organizimin si dhe kompetencat e NJTR-ve.

1.5 Në identifikimin dhe vlerësimin e përmbajtjes së formave aktuale zyrtare për hetimin e aksidenteve të trafikut rrugor, është analizuar përmbajtja e formave ekzistuese që janë përdorur në rastet e hetimit të aksidenteve të trafikut dhe është gjetur se Raporti Standard i Aksidentit të Trafikut nuk i përshtatet zhvillimit të gjithëmbarshtëm të vendit ngase i mungojnë shumë informata (rubrika) të cilat me kalimin e kohës janë paraqitur si të domosdoshme, p.sh.: informata (rubrika) për auto-rrugë, mungesa e Stemës së Republikës së Kosovës, etj.

1.6 Gjatë vlerësimit lidhur me zbatimin e procedurave të hetimit të aksidenteve në trafik, rezultoi fakti që dosjet e kontrolluara me formularët nga procedurat e hetimit të aksidenteve të trafikut nuk zbatohen në nivel të kënaqshëm. Në objektivin e parë, nga 99 dosjet e kontrolluara, 56% e këtyre dosjeve kanë qenë në përputhshmëri me kriteret matëse ndërsa 44% nuk ka qenë në përputhje me këto kriteret dhe nuk kanë përmbushur standardin e përcaktuar. Në objektivin e dytë që përfshinë mbikëqyrjen e formularëve nga 99 dosje të kontrolluara, 75% e këtyre dosjeve kanë qenë në përputhshmëri me kriteret matëse ndërsa 25% nuk kanë përmbushur këto kriteret dhe standardet e kërkuara. Objektivi i tretë apo detajet e hetimit të aksidentit të trafikut nga 99 dosje që janë kontrolluar, 62% prej tyre kanë qenë në përputhshmëri me kriteret matëse dhe standardin e kërkuar. Kurse, 38% prej dosjeve të

hetimit të aksidenteve të trafikut nuk kanë përmbushur në përpikëri kriteret matëse sipas standardit të përcaktuar. Sa i përket objektivit të fundit i cili është përcaktuar si i përgjithshëm nga 99 dosjet e kontrolluara ku gjendeshin vetëm 77 Raporte Standarde të Aksidenteve të Trafikut Rrugor, asnjëra nga to nuk kishte stemën e republikës së Kosovës duke mos përmbushur standardin e përcaktuar.

1.8 Bazuar në rezultatet e gjetura gjatë procesit të inspektimit, Inspektorati Policor i Kosovës i rekomandon Departamentit të Komunikacionit Rrugor-DPP Prishtinë dhe Njësive të Trafikut Rajonal, që nga niveli drejtues e deri tek vartësit e tyre, të kontribuojnë në profesionalizmin dhe përmirësimin e kontrollit të brendshëm me qëllim të evitimit të parregullsive dhe ngritjen e zbatueshmërisë së standardeve të punës gjatë procedurave hetimore në trafik. Po ashtu, rekomandohet që të mbahen trajnime të brendshme lidhur me kompletimin e dosjeve të rastit si dhe në plotësimin e formularëve të nevojshëm për hetimin e aksidenteve të trafikut rrugor. Kjo, pa dyshim do të ndikojë dukshëm në përmirësimin dhe freskimin e njohurive të reja në raport me ndryshimet që ndodhin në tërësi.

## 2. HYRJE

2.1 Në bazë të Ligjit të Inspektoratit Policor të Kosovës (Nr. 03/L-231, neni 24 pika 1 dhe 2) dhe Planit Vjetor të Inspektiveve 2012, me autorizimin e Kryeshefit Ekzekutiv, Departamenti i Inspektiveve ka bërë një Inspektim të Rregullt në kontrollimin dhe rishikimin e zbatimit të ligjit dhe procedurave në fuqi lidhur me hetimin e rasteve të aksidenteve të trafikut nga Policia e Kosovës.

2.2 Qëllim i këtij inspektimi ishte kontrollimi dhe analizimi i mostrave të marrura nga dosjet hetimore të aksidenteve në trafik, në mënyrë që ky proces inspektimi të verifikoj parregullsitë e mundshme që kanë të bëjnë me kontrollin dhe rishikimin e zbatimit të kuadrit ligjor si dhe në atë që Policia e Kosovës të përqendrohet në saktësinë, zbatimin e ligjit, përmirësimin e performancës policore në aspektin formal dhe organizativ të cilat rregullojnë çështjet e hetimeve të aksidenteve në trafik.

Qëllimi i këtij inspektimi ishte që të bëjë:

- Identifikimin dhe vlerësimin e procedurave të aksidenteve të trafikut
- Identifikimin dhe vlerësimin e përmbajtjes së formave zyrtare për aksidentet e trafikut
- Identifikimin dhe vlerësimin e zbatimit të procedurave për aksidentet e trafikut

2.3 Objektivat që synon t'i arrij ky inspektim:

- Identifikimi dhe vlerësimi i përputhshmërisë së procedurave të hetimit të aksidenteve të trafikut në Policinë e Kosovës me Ligjet në fuqi.
- Identifikimi dhe vlerësimi i përputhshmërisë së formave të procedurave të hetimit të aksidenteve të trafikut në Policinë e Kosovës me Ligjet në fuqi.
- Identifikimi i zbatimit të procedurave të hetimit të aksidenteve të trafikut që kanë të bëjnë me kompletimin dhe harmonizimin e formularëve që janë të përmbledhura në dosje.
- Identifikimi dhe zbatimi i procedurave lidhur me mbikëqyrjen e përfilljes së procedurave të hetimit të aksidenteve të trafikut.
- Identifikimi dhe zbatimi i procedurave rreth detajeve të hetimeve të aksidenteve të trafikut.
- Gjatë procesit të këtij inspektimi janë identifikuar edhe çështje tjetra të përgjithshme.

2.4 Çështja e hetimeve sa i përket hetimit të aksidenteve të trafikut është e një rëndësie të veçantë sepse kjo renditet një ndër fushat me ndjeshmëri të lartë në aspektin policor, gjë me të cilën ballafaqohen drejtpërdrejtë qytetarët me autoritetin policor në zbatim të ligjit, duke përfshirë këtu respektimin e parimeve dhe kuadrit ligjor në fushën e hetimeve të trafikut.

2.5 Si kriter matës Inspektorati Policor i Kosovës ka marrë: Kodin Penal, Ligjin e Policisë, Ligjin për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor, Ligjin për Përdorimin e Simboleve Shtetërore

të Kosovës, Doracakun Operacional për Trafik, Doracakun e Parimeve dhe Procedurave P-5.18, dhe Udhëzimin Administrativ për Mënyrën e Kryerjes së Detyrave dhe Ushtrimit të Autorizimeve Policore Nr. 05/2009.

2.6 Në këtë inspektim si metodologji është përdorur metoda Randomizer - një algoritëm (metodë rasti) që përzgjedh numrat në mënyrë të rastësishme, të paanshme dhe të pavarur. Për këtë janë zgjedhur mostra zyrtare nga popullacioni prej 7373 dosjeve të rasteve dhe janë kontrolluar 99 dosje të rasteve të aksidenteve të trafikut të përzgjedhura nga kjo metodë me një përzgjedhje të rrumbullakimit të madhësisë së mostrës në numrin më të përafërt të plotë ku janë përfshirë dosjet e aksidenteve të trafikut në gjashtë (6) Njësi të Trafikut Rajonal, si në vijim:

Njësia e Trafikut Rajonal - **Prishtinë**, Njësia e Trafikut Rajonal - **Pejë**, Njësia e Trafikut Rajonal - **Prizren**, Njësia e Trafikut Rajonal - **Gjilan**, Njësia e Trafikut Rajonal - **Ferizaj**, Njësia e Trafikut Rajonal - **Mitrovicë**.

2.7 Madhësia e mostrës është përzgjedhur me një testim prej 95% të saktësisë me lartësi të gabueshmërisë plus- minus deri në 5%. Mostra është përzgjedhur në periudhën kohore prej datës 01 janar 2011 deri më 31 dhjetor 2011, ku si qëllim kryesor ka përcaktimin e përputhshmërisë së dosjeve të aksidenteve të trafikut me standardet e inspektimit të objektivave.

### 3. PËRSHKRIMI I OBJEKTIVIT DHE TË GJETURAT

#### 3.1 Identifikimi dhe vlerësimi i procedurave të hetimit të aksidenteve të trafikut

3.1.1 Qëllimi i parë i këtij inspektimi ishte identifikimi dhe vlerësimi i procedurave të hetimit të aksidenteve të trafikut. Sipas analizave të bëra nga dokumentacioni bazë është identifikuar dhe vlerësuar rregullativa ligjore me të cilat punojnë zyrtarët policor në fushën e trafikut si: Kodi Penal, Ligji i Policisë, Ligji për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor, Doracaku Operacional për Trafik, Doracaku i Parimeve dhe i Procedurave P-5.18 dhe Udhëzimi Administrativ për Mënyrën e Kryerjes së Detyrave dhe Ushtrimit të Autorizimeve Policore Nr. 05/2009.

3.1.2 Gjatë analizimit dhe krahasimit të këtyre rregullativave ligjore, Inspektorati Policor ka gjetur se procedurat e punës në hetimin e aksidenteve të trafikut të cilat i ka përdorur Policia e Kosovës gjatë vitit 2011 ishin procedura në përdorim që nga dhjetori i vitit 2002 kur ka filluar mënyra e trajtimit të trafikut rrugor nga SHPK/UNMIK përmes një Doracaku Operacional të Trafikut. Në atë kohë hetimet e aksidenteve të trafikut janë kryer nga SHPK-ja gjegjësisht nga Zyra e Shërbimeve të Trafikut.

3.1.3 Ky doracak i ka përmbushur nevojat e shërbimeve ndaj qytetarëve gjatë kohës kur është hartuar, mirëpo me zhvillimet që ka pasur Republika e Kosovës nga viti 2002 e deri me 2011 ky dokument është dashur të jetë objekt i rishikimit disa herë pasi që ky doracak është një dokument dinamik dhe duhet gjithmonë të jetë në koherencë me ndryshimet ligjore dhe ndryshimet tjera infrastrukturore.

3.1.4 Inspektorati Policor ka gjetur se Njësitë e Trafikut Rajonal ende nuk posedojnë Procedura Standarde të Operimit (PSO) që do të përshkruanin dhe përcaktonin në mënyrë unike e standarde punët e NJTR duke përfshirë: autorizimet, fushëveprimet, detyrat dhe kufizimet e autorizimeve, organizimin dhe kompetencat e NJTR-ve. Në këtë drejtim ka pasur përpjekje nga disa njësi individuale për të hartuar një procedurë të tillë (p.sh. NJTR-Gjilan) e cila do të harmonizonte këto ndryshime ligjore dhe infrastrukturore në një PSO që do të përdorej nga zyrtarët policorë gjatë hetimit të aksidenteve të trafikut në veçanti dhe menaxhimit të trafikut rrugor në përgjithësi.

#### **REKOMANDIMI NR. 1**

**Inspektorati Policor i Kosovës i rekomandon Drejtorit të Departamentit të Komunikacionit Rrugor DPP-Prishtinë, hartimin e Procedurës Standarde të Operimit (PSO) unike për Njësitë e Trafikut Rajonal që do të përshkruante dhe përcaktonte në mënyrë unike e standarde punët e NJTR-ve duke përfshirë: autorizimet, fushëveprimet, detyrat dhe kufizimet e autorizimeve, organizimin dhe kompetencat e NJTR-ve me qëllim të ngritjes së performancës, profesionalizmit dhe imazhit të PK-së, në pajtim me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme si dhe risive infrastrukturore.**



## **3.2 Identifikimi dhe vlerësimi i përmbajtjes së formave zyrtare për aksidentet e trafikut**

3.2.1 Edhe pse për këtë fushë inspektimi, akoma mungon PSO-ja dhe ende veprohet duke u bazuar në Doracakun Operacional për Trafik i hartuar që nga viti 2002, IPK-ja ka identifikuar kuadrin ligjor shtesë me të cilët Policia e Kosovës ka rregulluar çështjet e hetimeve të aksidenteve në trafik, në saje të të cilave paraqiten një sërë formularësh që përdoren nga Policia e Kosovës. Inspektorati Policor i Kosovës gjatë këtij inspektimi si qëllim të dytë ka pasur edhe identifikimin dhe vlerësimin e përmbajtjes së këtyre formularëve për të parë se a i përmbajnë të gjitha informatat e kërkuara ashtu siç e parasheh kjo kornizë ligjore.

3.2.2 IPK-ja gjatë inspektimit ka konstatuar se forma bazë për hetimin e një aksidenti të trafikut ishte Raporti Standard i Aksidentit të Trafikut Rrugor, i cili përmbante rubrika me informata bazë që duhet të plotësohen nga zyrtarët policor, si: datën e aksidentit, kohën, lokacionin, koordinatat, me lëndime, me dëme të tjera materiale, emrat e të lënduarve, prezencën e policisë, automjetet e përfshira në aksident, kompania e sigurimit, lloji i automjeteve, të dhënat për shoferët, patentë shoferi, të dhënat për pronarin, dëmi, skica, detajet e aksidentit, fletëparaqitja dhe në fund, data, zyrtari, stacioni, nr. KI.

3.2.3 Ky Raport Standard i Aksidentit të Trafikut Rrugor, për kohën kur është hartuar, vlerësohet në pajtim me standardet dhe praktikat e mira nga vendet e përparuara për hetimin e aksidenteve në trafikun rrugor. Mirëpo, zhvillimi i gjithëmbarshtëm në vend, detyrimisht na imponon plotësimin e këtij raporti standard të aksidenteve në trafikun rrugor me rubrika shtesë, si p.sh.: aprovimi i ligjeve të reja në lidhje me përcaktimin e shpejtësisë së lejuar me rastin e ndërtimit të autostradës, vendosja e simboleve shtetërore të Kosovës, etj.

3.2.4 Gjatë kësaj analize janë identifikuar edhe formularë tjerë të ndryshëm të cilët ishin paraparë që të përmbanin dëshmi të paraqitura në: diagrame (skema) të bazuara në matjet nga tereni, fotografi që përfshijnë tërë vendin e ngjarjes dhe dëshmitë në detaje, deklaratat nga pjesëmarrësit dhe dëshmitarët, forma të veçanta për matjen e alkoolit në gjak, etj. Prandaj, të gjitha këto forma ishin paraparë për të marrë të dhëna nga tereni dhe për të kompletuar një dosje të hetimit të aksidentit të trafikut që të ndihmojnë organet e drejtësisë për të gjykuar më lehtë dhe drejtë në lidhje me lëshimet nga ngasësit e përfshirë në aksidentet e trafikut.

3.2.5 Deri më tani në legjislaturën e Republikës së Kosovës janë aprovuar shumë ligje, rregullore dhe udhëzime administrative në fushën e sigurisë rrugore, prandaj edhe këta formularë, përfshirë Formën e Raportit Standard të Aksidentit të Trafikut, do të duhej të ishin azhurnuar krahas ndryshimeve në legjislaturë dhe të jenë në përputhshmëri me ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës.

### **REKOMANDIMI NR. 2**

**Inspektorati Policor i Kosovës i rekomandon Drejtorit të Departamentit të Komunikacionit Rrugor DPP-Prishtinë, që sa më shpejtë të bëjë rishikimin dhe plotësimin e Raportit Standard të Aksidenteve në Trafikun Rrugor me informata shtesë konform ligjeve dhe ndryshimeve tjera.**

### **3.3 Identifikimi dhe vlerësimi i zbatimit të procedurave për hetimin e aksidenteve në trafik**

3.3.1 Siç dihet çdo formë zyrtare ka informatat bazë të cilat paraqiten në formular dhe është e obligueshme që secili dhe çdo vend i zbrazët duhet të plotësohet. Nëse zyrtarit policor, në vendin e ngjarjes i duhet më shumë hapësirë ai/ajo mund të përdor fletë tjera shtesë. Në kuadër të qëllimit të tretë që ka të bëjë me vlerësimin e zbatueshmërisë së këtyre formularëve në përputhje me procedurat e përcaktuara, Inspektorati Policor i Kosovës ka gjetur një përqindje të ultë të saktësisë së zbatueshmërisë të këtyre procedurave të cilat janë paraqitur më poshtë.

3.3.2 Duhet theksuar se metoda e punës që ka të bëjë me vlerësimin e zbatueshmërisë së këtyre formularëve ka përcaktuar kriterin sipas të cilit objektivat kanë ndërthurur në vete një pyetësor i cili ka parapa për secilin objektiv pyetje të veçanta të cilat do të na japin informatat lidhur me nivelin e përmbushjes së objektivit.

#### **a) Të gjeturat në mënyrë të përgjithshme**

##### **➤ Objektivi 1- Kompletimi dhe Harmonizimi**

Në objektivin e parë, nga 99 dosjet e kontrolluara 55% e këtyre dosjeve kanë qenë në përputhshmëri me kriteret matëse ndërsa 45% nuk ka qenë në përputhje me kriteret matëse dhe nuk kanë përmbushur standardin e përcaktuar.

##### **➤ Objektivi 2 - Mbikëqyrja**

Në objektivin e dytë që përfshinë mbikëqyrjen e formularëve, nga 99 dosje të kontrolluara 75% e këtyre dosjeve kanë qenë në përputhshmëri me kriteret matëse ndërsa 25% nuk kanë qenë në përputhje me kriteret matëse dhe nuk kanë përmbushur standardin e përcaktuar.

##### **➤ Objektivi 3 - Detajet e hetimeve të aksidentit të trafikut**

Objektivi i tretë apo detajet e hetimit të aksidentit të trafikut, nga 99 dosjet që janë kontrolluar 62% prej tyre kanë qenë përputhshmëri me kriteret matëse, apo në përputhje me standardin e kërkuar. Ndërsa, 38% prej dosjeve të hetimit të aksidentit të trafikut nuk kanë përmbushur kriteret matëse sipas standardit të përcaktuar.

##### **➤ Objektivi 4 - E Përgjithshmja**

Dhe në objektivin e fundit i cili është përcaktuar si i përgjithshëm nga 99 dosjet e kontrolluara ku gjendeshin vetëm 77 Raporte Standarde të Aksidenteve të Trafikut Rrugorë asnjëra nga to nuk kishte stemën e republikës së Kosovës pra nuk kanë përmbushur standardin e përcaktuar.

Tabela 1			
Përmbledhja e të gjeturave të përgjithshme			
Nr. Objektivit	Përshkrimi i objektivit	Totali i raporteve të kontrolluara	Përmbledhja në përqindje sipas standardeve
1	Kompletimi dhe Harmonizimi	99	55%
2	Mbikëqyrja	99	75 %
3	Detajet e hetimit të aksidentit të trafikut	99	62%

## b) Të gjeturat e detajuara sipas objektivave

### Objektivi 1 - Kompletimi dhe harmonizimi/kriteri

- **Kriteri:** Në Doracakun Operacional për Trafik seksioni 3, pika 7.3, kërkohet që të plotësohet raporti standard i aksidenteve të trafikut me një skicë të detajuar e cila duhet të kompletohet me të gjitha të dhënat e kërkuara dhe duhet të jetë pjesë e dosjes së rastit.
- **Procedura e inspektimit:** Është bërë kontrollimi i të gjitha formave që përfshijnë dosjet e rasteve të aksidenteve dhe janë verifikuar se:
  - ✓ A e posedon Dosja e Rastit formën e Raportit Standard të Aksidentit të Trafikut?
  - ✓ A është e kompletuar-plotësuar- forma e Raportit Standard të Aksidentit të Trafikut?
  - ✓ A kanë formë unike Formularët e deklaratave të palëve të përfshira në aksidente?

### Të gjeturat:

Në objektivin e parë, Kompletimi dhe Konsistenca, është konstatuar se:

- Nga 99 dosje të rasteve të aksidentit të trafikut të kontrolluara vetëm 78% e dosjeve përmbajnë Raportin Standard të Aksidentit të Trafikut Rrugor, ndërsa 22% e dosjeve nuk kanë Raportin Standard të Aksidentit në Trafikun Rrugor.
- Rubrikat e caktuara në Raportin Standard të Aksidentit në Trafikun Rrugor vetëm në 21% të tyre janë plotësuar, ndërsa 79% të këtyre raporteve nuk janë plotësuar tërësisht.
- Forma unike e deklaratave të palëve të përfshira në aksident përdoret vetëm në 67% të rasteve, ndërsa në 33% të rasteve format e deklaratave janë të formave të ndryshme dhe jo standarde.

Nga 99 dosje të kontrolluara, është gjetur se 22 dosje nuk e kanë Raportin Standard të Aksidenteve në Trafik. Dosjet me mungesë të Raportit Standard të Aksidentit në Trafik janë gjetur në Njësinë e Trafikut Rajonal të Prizrenit, ku në 21 dosje apo 92% nga gjithsej 23 dosje të kontrolluara, nuk kanë pasur Raportin Standard të Aksidentit në Trafik. Ndërsa, në Njësinë e Trafikut Rajonal Mitrovicë nga 10 dosje të kontrolluara, 1 (një) (apo 10% nga totali) është gjetur pa Raport Standard të Aksidentit të Trafikut.

Në Tabelën 2 janë të dhënat lidhur me kompletimin dhe konsistencën në përmbushjen e objektivit të parë mbi zbatimin e procedurave të hetimit të aksidenteve të trafikut për secilën Njësi Regjionale të Trafikut dhe totalin në nivel qendror.

Tabela 2										
Nr. 1	NJRT- Njësitë Rajonale të Trafikut	OBJEKTIVI 1, KOMPLETIMI DHE KONSISTENCA								
		A e posedon, Dosja e rastit, formën e Raportit Standard të Aksidentit të Trafikut?			A është e kompletuar- plotësuar- forma e Raportit Standard të Aksidentit të Trafikut?			A kanë formë unike Formularët e deklaratave të palëve të përfshira në aksidente?		
		Gjithsej	Po	Jo	Gjithsej	Po	Jo	Gjithsej	Po	Jo
1	<b>Prishtina</b>	21	21	0	21	9	12	21	5	16
	Përqindja	100%	100%	0	100%	42%	58%	100%	24%	76%
2	<b>Prizreni</b>	23	2	21	2	0	2	23	15	8
	Përqindja	100%	8%	92%	100%	0	100%	100%	65%	35%
3	<b>Mitrovica</b>	10	9	1	9	4	5	10	6	4
	Përqindja	100%	90%	10%	100%	40%	60%	100%	60%	40%
4	<b>Ferizaj</b>	9	9	0	9	2	7	9	7	2
	Përqindja	100%	100%	0	100%	22%	78%	100%	78%	22%
5	<b>Peja</b>	29	29	0	29	0	29	29	27	2
	Përqindja	100%	100%	0	100%	0	100%	100%	93%	7%
6	<b>Gjilani</b>	7	7	0	7	0	7	7	6	1
	Përqindja	100%	100%	0	100%	0	100%	100%	90%	10%
<b>Gjithsej</b>		<b>99</b>	<b>77</b>	<b>22</b>	<b>77</b>	<b>15</b>	<b>62</b>	<b>99</b>	<b>66</b>	<b>33</b>
<b>Përqindja</b>		<b>100%</b>	<b>78%</b>	<b>22%</b>	<b>100%</b>	<b>21%</b>	<b>79%</b>	<b>100%</b>	<b>67%</b>	<b>33%</b>
<b>Totali pozitiv i zbatimit të Objektivit</b>		<b>55%</b>								

### REKOMANDIMI NR. 3

Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon Komandantët e Njësisë të Trafikut Rajonal e në veçanti Njësisë së Trafikut Rajonal të Prizrenit dhe Mitrovicës që dosjet e hetimit të aksidentit të trafikut rrugor duhet të inspektohen rregullisht dhe të sigurohet se secila dosje të ketë Raportin Standard të Aksidentit Rrugor dhe të kompletohet (plotësohet) forma e raportit të aksidentit në të gjitha rubrikat e saj. Po ashtu duhet të sigurohen që formularët e deklaratave të palëve të përfshira në aksidente të kenë formë unike dhe këto standarde të përmbushen në masën 100%.

## Objektivi 2 – Mbikëqyrja

- **Kriteri:** Në Doracakun Operacional për Trafik seksioni 3 veprimet e përgjithshme për aksident pika 13, thuhet: Është obligim i zyrtarit policor të përcaktoj cilat ligje janë thyer, duke u bazuar në fakte, llogaritje shkencore, deklaratave apo faktorë tjerë që do të kenë shkaktuar aksident trafik, gjë që duhet të ceket qartë në raportin e aksidentit. Po ashtu, seksioni 8 pika 4 dhe seksioni 9 pika 7 e obligojnë policin hetues të kompletojë raportin standard të aksidentit. Ndërsa, seksioni 5 përcakton marrjen e deklaratave nga vozitësit (shoferët e përfshirë në aksident), kurse seksioni 6 përcakton marrjen e deklaratave nga dëshmitarët.
- **Procedura e inspektimit:** Në këtë objektiv është kontrolluar secila dosje e rastit të aksidenteve në trafik dhe është verifikuar se:
  - ✓ A përcaktohet nga raporti i aksidentit statusi i rastit (penal/kundërvajtje)?
  - ✓ A përmban dosja e rastit raportin e policit hetues?
  - ✓ A e ka nënshkruar i dyshuari deklaratën e tij?
  - ✓ A e ka nënshkruar viktimat/dëshmitarët deklaratën e tij?

### Të gjeturat:

Në objektivin e dytë, Mbikëqyrja, është konstatuar se:

- Në 84% të Raporteve Standarde të Aksidenteve të Trafikut përcaktohet qartë statusi i rastit (penal/kundërvajtje), ndërsa në 16% të rasteve ajo nuk përcaktohet qartë,
- Raportet e policit hetues gjenden në dosjen e rastit vetëm në 69% të rasteve, kurse në 31% të rasteve ajo nuk gjendet në dosjen e rastit,
- Deklarata e të dyshuarit është e nënshkruar vetëm në 77% të rasteve, kurse 23% e deklaratave të të dyshuarve në kuadër të këtyre dosjeve ishin të pa nënshkruara,
- Deklaratat e viktimave dhe dëshmitarëve janë të nënshkruara në 66% të rasteve, kurse 34% të këtyre deklaratave nuk janë të nënshkruara fare.

Në Tabelën 3 do të gjeni të dhënat lidhur me Mbikëqyrjen në përmbushjen e objektivit të dytë mbi zbatimin e procedurave të hetimit të aksidenteve të trafikut për secilën Njësi Regjionale të Trafikut dhe totalin në nivel qendror.

**REKOMANDIMI NR. 4**

Inspektorati Policor i Kosovës i rekomandon komandantët e Njësive të Trafikut Rajonal që të zhvillojnë inspektime për të përmirësuar mbikëqyrjen duke u kujdesur që vartësit e tyre në vitin e ardhshëm në të gjitha Raportet Standard të Aksidenteve në Trafikun Rrugor të përshkruajnë saktë se cilat ligje janë shkelur në aksidentin e trafikut rrugor dhe të përcaktohet statusi i rastit. Po ashtu, në të gjitha dosjet e rastit të vendosin raportin e policit hetues për aksidentin në trafikun rrugor, në deklaratat e të dyshimëve të vendoset nënshkrimi i të dyshimit si dhe në të gjitha deklaratat e viktimës/dëshmitarit të vendoset nënshkrimi i viktimës/dëshmitarit. Ky objektivi duhet të përmbushet në masën 100%.

**Tabela 3**

NJRT- Njësiti e Trafikut Regjional		Objektivi 2 - Mbikëqyrja											
		A përcaktohet nga raporti i aksidentit statusi i rastit (penal/kundërvajtje)?			A përmban dosja e rastit raportin e policit hetues?			A e ka nënshkruar i dyshuari deklaratën e tij?			A e ka nënshkruar viktimën/dëshmitari deklaratën e tij?		
		Gjithsej	Po	Jo	Gjithsej	Po	Jo	Gjithsej	Po	Jo	Gjithsej	Po	Jo
1	<b>Prishtina</b>	21	21	0	21	5	16	21	7	14	21	5	16
	Përqindja	100%	100%	0	100%	23%	77%	100%	33%	62%	100%	23%	72%
2	<b>Prizreni</b>	2	0	2	23	23	0	23	20	3	23	18	5
	Përqindja	100%	0	100%	100%	100%	0	100%	86%	14%	100%	78%	12%
3	<b>Mitrovica</b>	9	9	0	10	4	6	10	6	4	10	6	4
	Përqindja	100%	90%	10%	100%	40%	60%	100%	60%	40%	100%	60%	40%
4	<b>Ferizaj</b>	9	9	0	9	5	4	9	9	0	9	5	4
	Përqindja	100%	100%	0	100%	55%	45%	100%	100%	0	100%	55%	45%
5	<b>Peja</b>	29	21	8	29	29	0	29	27	2	29	24	5
	Përqindja	100%	72%	28%	100%	100%	0	100%	93%	7%	100%	82%	18%
6	<b>Gjilani</b>	7	6	1	7	2	5	7	6	1	7	6	1
	Përqindja	100%	85%	14%	100%	28%	72%	100%	85%	15%	100%	85%	15%
<b>Gjithsej:</b>		<b>77</b>	<b>66</b>	<b>11</b>	<b>99</b>	<b>68</b>	<b>31</b>	<b>99</b>	<b>76</b>	<b>23</b>	<b>99</b>	<b>65</b>	<b>34</b>
<b>Përqindja</b>		<b>100%</b>	<b>87%</b>	<b>13%</b>	<b>100%</b>	<b>69%</b>	<b>31%</b>	<b>100%</b>	<b>77%</b>	<b>23%</b>	<b>100%</b>	<b>66%</b>	<b>34%</b>
<b>Totali pozitiv i zbatimit të Objektivit</b>		<b>75%</b>											

### Objektivi 3 – Detajet e hetimeve të aksidenteve

- **Kriteri:** Në Doracakun Operacional për Trafik seksioni 3 përshkruhen veprimet e përgjithshme për aksident dhe pika 13 thotë: është obligim i zyrtarit policor të përcaktoj çfarë ligje janë thyer, duke u bazuar në fakte, llogaritje shkencore, deklaratat apo faktorë tjerë që do të kenë shkaktuar aksident trafik, gjë që duhet të ceket qartë në raportin e aksidentit. Në bazë të nenit 211, zyrtari policor i cili bënë ekzaminimin e vendit të aksidentit, duhet me mjete përkatëse ose në ndonjë institucion profesional të bëjë (kërkojë) kontrollin se a kanë në organizëm alkool apo droga narkotike.
- **Procedura e inspektimit:** Lidhur me këtë objektiv është bërë kontrollimi i dosjeve për të parë se a është respektuar procedura në mënyrë të detajuar gjatë hetimeve të aksidenteve të trafikut rrugor nga ana e Policisë së NJTR-ve, konform ligjit dhe atë duke u përgjigjur në pyetjet, si:
  - ✓ A është bërë skicimi i vendit të ngjarjes?
  - ✓ A është bërë fotografimi i vendit të ngjarjes?
  - ✓ Fotot e vendit të ngjarjes a kanë përshkrim?
  - ✓ A ekzistojnë deklaratat e palëve të përfshira në aksident?
  - ✓ Pjesëmarrësit e përfshirë në aksident komunikacioni a iu janë nënshtruar alkooltestit?

### Të gjeturat:

Në objektivin e tretë, Detajet e hetimeve të aksidenteve të trafikut, është konstatuar se:

- Skicimi i vendit të ngjarjes është bërë në 66% të rasteve, ndërsa në 34% të rasteve nuk është bërë skicimi i vendit të ngjarjes,
- Fotografimi i vendit të ngjarjes është bërë në 83% të rasteve, ndërsa në 17% të rasteve nuk ka pasur fotografim të vendit të ngjarjes,
- Përshkrimi i fotografive të vendit të ngjarje është bërë vetëm në 8% të rasteve, ndërsa në 92% të rasteve nuk është bërë përshkrimi i fotografive të vendit të ngjarjes,
- Deklaratat e palëve të përfshira në aksident të trafikut gjenden në dosjet e rastit vetëm në 79% të rasteve, kurse në 20% të rasteve nuk ekzistojnë të gjitha deklaratat e palëve të përfshira në aksident.
- Palët e përfshira në aksident i janë nënshtruar alkool-testit vetëm në 76% të rasteve kurse në 24% të rasteve palët nuk i janë nënshtruar fare alkool-testit.

Në Tabelën 4 do të gjeni të dhënat lidhur me detajet e hetimit të aksidenteve të trafikut në përmbushjen e objektivit të tretë mbi zbatimin e procedurave të hetimit të aksidenteve të trafikut për secilën Njësi Regjionale të Trafikut dhe totalin në nivel qendror.

**REKOMANDIMI NR. 5**

Inspektorati Policor i Kosovës i rekomandon Komandantëve të Njësive të Trafikut Rajonal të kujdesen dhe të marrin masa që vartësit e tyre, të bëjnë skicimin, fotografimin e vendit të ngjarjes së aksidentit, përshkrimin e fotografive, të marrin deklaratat e palëve të përfshira në aksidentet e trafikut rrugor dhe të përdorin formën unike të deklaratës si dhe të zbatojnë nenin 211 të Ligjit për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor Nr. 02/L-70 në lidhje me kontrollin për alkotest dhe droga narkotike ndaj pjesëmarrësve në aksidentin e komunikacionit rrugor dhe që në vitin e ardhshëm të mos përsëritën këto lëshime dhe ky objektiv të përmbushet në masën 100%.

**Tabela 4**

NJRT- Njësiti e Trafikut Regjional	Objektivi 3 - Detajet e hetimeve të aksidenteve														
	A është bërë skicimi i vendit të ngjarjes?			A është bërë fotografimi i vendit të ngjarjes?			A kanë përshkrim fotot e vendit të ngjarjes?			A ekzistojnë deklaratat e palëve të përfshira në aksident?			A iu janë nënshtruar alkooltestit pjesëmarrësit e përfshirë në aksident komunikacioni ?		
	Gjithsej	Po	Jo	Gjithsej	Po	Jo	Gjithsej	Po	Jo	Gjithsej	Po	Jo	Gjithsej	Po	Jo
<b>Prishtina</b>	21	20	1	21	9	12	21	2	19	21	7	14	21	13	8
Përqindja	100%	95%	5%	100%	43%	57%	100%	10%	90%	100%	38%	62%	100%	62%	38%
<b>Prizreni</b>	23	13	10	23	20	3	23	2	21	23	22	1	23	23	0
Përqindja	100%	56%	44%	100%	86%	14%	100%	8%	92%	100%	95%	5%	100%	100%	0
<b>Mitrovica</b>	10	6	4	10	9	1	10	1	9	10	6	4	10	8	2
Përqindja	100%	60%	40%	100%	90%	10%	100%	10%	90%	100%	60%	40%	100%	80%	20%
<b>Ferizaj</b>	9	9	0	9	9	0	9	1	8	9	9	0	9	5	4
Përqindja	100%	100%	0%	100%	100%	0%	100%	11%	89%	100%	100%	0%	100%	55%	45%
<b>Peja</b>	29	11	18	29	28	1	29	0	29	29	28	1	29	20	9
Përqindja	100%	37%	63%	100%	96%	4%	100%	0%	100%	100%	96%	4%	100%	79%	31%
<b>Gjilani</b>	7	3	4	7	7	0	7	2	5	7	6	1	7	4	3
Përqindja	100%	43%	57%	100%	100%	0%	100%	28%	72%	100%	85%	15%	100%	57%	43%
<b>Gjithsej:</b>	99	62	37	99	82	17	99	8	91	99	78	21	99	73	26
Përqindja	100%	66%	34%	100%	83%	17%	100%	8%	92%	100%	79%	21%	100%	75%	25%
<b>Totali pozitiv i zbatimit të Objektivit</b>	<b>62%</b>														



#### **Objektivi 4 - Të përgjithshme**

**Procedura e inspektimit:** Nga të gjitha dosjet e kontrolluara kanë dalë në pah edhe çështje tjera të cilat nuk kualifikohen në tre objektivat e parë por që ia vlen të theksohen, si p.sh. vendosja e stemave shtetërore në dokumente zyrtare.

**Të gjeturat:** Raporti standard i aksidentit në trafikun rrugor nuk përmban Stemën e Republikës së Kosovës.

Nga 99 dosje të kontrolluara janë gjetur vetëm 77 raporte të aksidenteve ku konstatohet mos vendosja e Stemës së Republikës së Kosovës në raportin standard të aksidentit në trafikun rrugor.

#### **REKOMANDIMI NR. 6**

**Inspektorati Policor i Kosovës i rekomandon Drejtorit të Departamentit të Komunikacionit Rrugor DPP-Prishtinë që të vendoset Stema e Republikës së Kosovës në të gjitha dokumentet dhe formularët që dalin nga kjo drejtori konform Ligjit për përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës .**

## 4. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

### 4.1 Përfundimet

4.1.1 Gjatë këtij inspektimi lidhur me Identifikimin dhe Vlerësimin e Procedurave të Aksidenteve të Trafikut, është gjet se Njësitë e Trafikut Rajonal (edhe pse tanimë është ndërtuar një rregullativë ligjore me Ligjin për Komunikacion dhe ligje tjera) nuk kanë Procedura Standarde të Operimit të rishikuara dhe në përputhje me ndryshimet legislative dhe infrastrukturore në Kosovë. Njësitë e Trafikut Rajonal ende punojnë me një Doracak Operacional për Trafik i cili duhet të rishikohet dhe të plotësohet me ndryshimet e reja në Republikën e Kosovës. Kjo Procedurë Standarde e Operimit (PSO) do të duhej të përshkruante dhe përcaktonte në mënyrë unike e të qartë punën e NJTR-ve duke përfshirë: autorizimet, fushëveprimet, detyrat dhe kufizimet e autorizimeve, organizimin dhe kompetencat e NJTR-ve rajonale.

4.1.2 Në qëllimin e dytë, Identifikimi dhe Vlerësimi i Përmbajtjes së Formave Zyrtare për Aksidentet e trafikut, Inspektorati Policor i Kosovës ka analizuar përmbajtjen e formave ekzistuese të rasteve të aksidenteve të trafikut dhe ka gjetur se Raporti Standard i Aksidentit të Trafikut nuk i përshtatet zhvillimit të gjithëmbarshtëm të vendit, është i vjetruar dhe i mungojnë rubrika e informata të cilat janë obligative me legjislacionin në fuqi. Gjendje e njëjtë është edhe me format tjera në përdorim të cilat duhet të azhurnohen sa më shpejtë dhe të renditen në kuadër të një PSO-je unike për gjashtë NJTR-të rajonale.

4.1.3 Në qëllimin e tretë, Identifikimi dhe Vlerësimi i Zbatimit të Procedurave për Hetimin e Aksidenteve të Trafikut në fuqi, Inspektorati Policor ka gjetur se procedurat dhe formularët nga procedurat e hetimit të aksidenteve të trafikut nuk zbatohen në nivel të kënaqshëm dhe lënë shumë për të dëshiruar, p.sh.: në dosjet e kontrolluara të rasteve, 22% e dosjeve nuk kanë raport standard të aksidentit. Rubrikat e caktuara në raportin standard të aksidentit në trafikun rrugor në 80% të tyre nuk plotësohen, ndërsa 12% e këtyre raporteve nuk bëjnë përcaktimin e statusit të rastit. Raporti Standard i Aksidentit në Trafikun Rrugor nuk përmban Stemen e Republikës së Kosovës, skicimi i vendit të ngjarjes në 37% të rasteve nuk është bërë, fotografimi i vendit të ngjarjes nuk është bërë në 17% të rasteve, përshkrimi i fotografive të vendit të ngjarjes në 91% të rasteve nuk është bërë, deklaratat e palëve të përfshira në aksidentin e trafikut rrugor nuk janë të përfshira në 20% të dosjeve, format unifikuar të deklaratave për palët në 32% të rasteve nuk është përdorë, palët e përfshirë në aksidentin e trafikut rrugor nuk i janë nënshtruar alkooltestit në 48% të rasteve, dosja e hetimit të aksidentit nuk e përmban raportin e policit hetues në 31% të rasteve, nënshkrimi i deklaratës nga i dyshimti mungon në 23% të rasteve, ndërsa nënshkrimi i deklaratës nga viktimat/dëshmitari nuk është bërë në 31% të rasteve të kontrolluara.

4.1.4 Bazuar në këto të gjetura Inspektorati Policor i Kosovës vlerëson se Departamenti i Komunikacionit Rrugor DPP- Prishtinë dhe Njësitë e Trafikut Rajonal duhet që sa më shpejtë të fillojnë me hartimin e PSO-ve për trafikun rrugor me të gjithë formularët e rishikuar të cilët do të përdoren nga policët, të forcojë nivelin e mbikëqyrjes dhe kontrollit të brendshëm në radhët e saja për të evituar parregullsitë në zbatimin e procedurave të aplikueshme. Kjo, arrihet duke u siguruar se të gjitha format dhe rubrikat të plotësohen sipas rregullave, që ato të jenë të qarta, të

sakta dhe të plota në mënyrë që të jenë faktike për organet e drejtësisë dhe faktorët tjerë relevant.

4.1.5 Bazuar në rezultatet nga të gjeturat gjatë procesit të inspektimit, Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon Departamentin e Komunikacionit Rrugor - DPP Prishtinë dhe Njësitë e Trafikut Rajonal që nga niveli menaxhues e deri tek vartësit e tyre të marrin masa të menjëhershme dhe të kontribuojnë të gjithë së bashku drejtë profesionalizmit dhe përmirësimit të kontrollit të brendshëm, me qëllim të evitimit të parregullsive gjatë procedurave hetimore në aksidentet e trafikut. Po ashtu, rekomandojmë që të mbahen trajnime të rregullta dhe të specializuara lidhur me procedurat e hetimit të aksidenteve të trafikut si për zyrtarët policorë ashtu edhe për mbikëqyrësit lidhur me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Pa dyshim se kjo do të ndikonte dukshëm në përmirësimin dhe freskimin e njohurive të reja në lidhje me aksidentet në trafikun rrugor dhe në raport me ndryshimet që ndodhin në tërësi.

## 4.2 Rekomandimet

1. Inspektorati Policor i Kosovës i rekomandon Drejtorit të Departamentit të Komunikacionit Rrugor DPP-Prishtinë, hartimin e Procedurës Standarde të Operimit (PSO) unike për Njësitë e Trafikut Rajonal, e cila do të përshkruante dhe përcaktonte në mënyrë unike e standarde punët e NJTR-ve duke përfshirë: autorizimet, fushëveprimet, detyrat dhe kufizimet e autorizimeve, organizimin dhe kompetencat e NJTR-ve, me qëllim të ngritjes së performancës, profesionalizmit dhe imazhit të PK-së konform ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme.
2. Inspektorati Policor i Kosovës i rekomandon Drejtorit të Departamentit të Komunikacionit Rrugor DPP-Prishtinë që sa më shpejtë të bëjë rishikimin dhe plotësimin e Raportit Standard të Aksidenteve në Trafikun Rrugor me informata shtesë konform ligjeve dhe ndryshimeve tjera.
3. Inspektorati Policorë i Kosovës i rekomandon Komandantët e Njësive të Trafikut Rajonal e në veçanti të Njesisë së Trafikut Rajonal të Prizrenit dhe Mitrovicës që dosjet e hetimit të aksidenteve të trafikut rrugor duhet të inspektohen rregullisht dhe të sigurohet që secila dosje të ketë Raportin Standard të Aksidentit Rrugor. Përveç kësaj, duhet të kompletohet (plotësohet) forma e raportit të aksidentit në të gjitha rubrikat e saj e po ashtu duhet të sigurohen që formularët e deklaratave të palëve të përfshira në aksidente të kenë formë unike. Këto standarde të përmbushen në masën 100%.
4. Inspektorati Policor i Kosovës i rekomandon komandantët e Njësive të Trafikut Rajonal që të zhvillojnë inspektime për të përmirësuar mbikëqyrjen duke u kujdesur që vartësit e tyre në vitin e ardhshëm, në të gjitha Raportet Standarde të Aksidenteve në Trafikun Rrugor të përshkruajnë saktë se cilat ligje janë shkelur në aksidentin e trafikut rrugor dhe të përcaktohet statusi i rastit. Po ashtu, në të gjitha dosjet e rastit të vendosin raportin e policit hetues për aksidentin në trafikun rrugor, të kujdesen që në të gjitha deklaratat e të dyshimtëve të vendoset nënshkrimi i të dyshimtëve si dhe në të gjitha deklaratat e viktimës/dëshmitarit të vendoset nënshkrimi i viktimës/dëshmitarit. Ky objektivi duhet të përmbushet në masën 100%.
5. Inspektorati Policor i Kosovës i rekomandon Komandantëve të Njësive të Trafikut Rajonal të kujdesen dhe të marrin masa që vartësit e tyre, të bëjnë skicimin, fotografimin e vendit të ngjarjes së aksidentit, përshkrimin e fotografive, të marrin deklaratat e palëve të përfshira në aksidentet e trafikut rrugor dhe të përdorin formën unike të këtyre deklaratave, të zbatojnë nenin 211 të Ligjit për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor Nr. 02/L-70 në lidhje me kontrollin për alkooltest dhe droga narkotike ndaj pjesëmarrësve në aksidentin e komunikacionit rrugor dhe që në vitin e ardhshëm të mos përsëritën këto lëshime dhe ky objektivi të përmbushet në masën 100%.

6. Inspektorati Policor i Kosovës i rekomandon Drejtorit të Departamentit të Komunikacionit Rrugor DPP-Prishtinë që të vendoset Stema e Republikës së Kosovës në të gjitha dokumentet dhe formularët që dalin nga kjo drejtori konform Ligjit për përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës .

## BIBLIOGRAFIA

- Kodi Penal i Kosovës
- Ligjin i Policisë
- Ligji Për Përdorimin e Simboleve Shtetërore të Kosovës Nr. 03/L-38, 20 shkurt 2008
- Ligjin për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor Nr. 02/L-70, 11 janar 2007
- Doracaku i Parimeve dhe Procedurave të PK-së (Dhjetor 2009)
- Doracaku Operacional për Trafik (30.12.2002)